



**RAPORTIMI I ÇËSHTJEVE TË FËMIJËVE NË MEDIAN E
SHKRUAR:**

**MONITORIMI I PESË GAZETAVE TË
PËRDITSHME**

(QERSHOR-NËNTOR 2008)

Realizuar me mbështetjen e UNICEF

Hyrja

Për të pasur një ide sa më të mirë për mënyrën se si media pasqyron dhe paraqet fëmijët, një raport monitorues për pesë gazeta kryesore u krye për periudhën qershor-nëntor, 2008. Gazetat e përditshme përfaqësonin median kryesore dhe u përzgjedhën ato që mendohen se kanë edhe numrin më të madh të kopjeve të shitura. Meqë nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për shitjet e gazetave dhe tirazhin e tyre në përgjithësi, përzgjedhja e gazetave për monitorim u krye sipas konsultimeve me kryeredaktorët e të përditshmeve. Botimet e përditshme të përfshira në raportin monitorues ishin: *Shekulli*, *Panorama*, *Standard*, *Gazeta Shqiptare*, *Shqip*.

Gjatë kësaj kohe u monitoruan të gjithë artikujt që kishin të bënin me ose përfshinin apo preknin fëmijët. Fëmijët në këtë rast u përkufizuan si personat nën 18 vjeç. Për të pasur një pamje sa më të plotë që të jetë e mundur, artikujt që nuk përqendroheshin posaçërisht te fëmijët, por kishin të bënin me ta, u morën gjithashtu parasysh.

1. Analiza sasiore

Analiza e artikujve të monitoruar ishte si sasiore, ashtu edhe cilësore. Numri i përgjithshëm i artikujve të monitoruar ishte 1187 artikuj për të pesë gazetat. Artikujt e monitoruar nuk përfshinin vetëm lajmet, por edhe editorialet, reportazhet, lajmet e shkurtra, etj. Gjatësia e artikujve varionte nga dy paragrafë në një faqe të tërë gazete, në varësi të lajmit që paraqiste. Tabela e mëposhtme paraqet numrin e artikujve sipas gazetave dhe muajve përkatës.

Nr.	Gazeta	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Total
1	Shekulli	39	27	45	27	29	35	202
2	Panorama	35	30	43	48	31	28	215
3	Shqip	56	39	37	68	37	44	281
4	Standard	24	19	28	42	15	17	145
5	Gazeta Shqiptare	58	28	39	65	85	69	344
	TOTAL	212	143	192	250	197	193	1187


Grafiku i mëposhtëm paraqet pasqyrimin e të miturve sipas secilës gazetë, për të gjithë periudhën gjashtë-mujore të monitorimit:




Temat kryesore që dolën nga këto artikuj të monitoruar ishin kryesisht trafikimi i fëmijëve, dhuna në familje, arsimi, krimi dhe drejtësia për të miturit, problemet e adoleshentëve, etj. Tabela e mëposhtme pasqyron numrin e artikujve sipas ndarjes së temave, gjithsej dhe për çdo gazetë:

Temat e pasqyruara	Shekulli	Panorama	Shqip	Standard	Gazeta Shqiptare	Total
Kronika e zezë	90	124	97	44	113	468
Arsimi	27	37	116	57	116	353
Shëndetësia	46	32	35	23	37	173
Të tjera	39	22	33	21	78	193
Gjithsej	202	215	281	145	344	1187


I njëjti informacion paraqitet në grafikun e mëposhtëm sipas përqindjes përkatëse për periudhën gjashtë-mujore:




Si mund të shihet nga ndarja e artikujve sipas temave që trajtojnë, kronika e zezë mbetet ende tema mbizotëruese përse i përket pasqyrimin të të miturve nga shtypi i përditshëm. Në pasqyrimin total, ajo zë 39% të të gjithë hapësirës. Megjithatë, vlen të përmendet se shumica e artikujve që i përkasin kësaj teme janë në përgjithësi të shkurtër, me 2-3 paragrafë, edhe pse ka përjashtime. Ndërkohë, për temat e tjera në përgjithësi artikujt janë më të gjatë, si është rasti i arsimit, për shembull. Gjithashtu, gazeta të ndryshme kanë përparësi të ndryshme. Grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë temat e mbuluara nga secila gazetë për periudhën gjashtë-mujore:




Ndarja e temave ne gazeten Panorama
Qershor- Nentor 2008




Ndarja e temave ne gazeten Shqip
Qershor-Nentor 2008



Ndarja e temave ne gazeten Standart
Qershor-Nentor 2008



Ndarja e temave ne Gazeta Shqiptare
Qershor-Nentor 2008



2. Analiza cilësore

Përgjithësisht gazetave vazhdojnë të jenë të qëndrueshme në lidhje me temat për fëmijët që ato pasqyrojnë. Megjithatë, siç do të tregohet dhe më tej, ekzistojnë dallime midis gazetave për mënyrën e pasqyrit të këtyre temave. Përveç larmisë së temave të pasqyruara dhe informacionit të sjellë, analiza përqendrohet edhe në sjelljen etike të gazetave me fëmijët, në interesin publik përballë mbrojtjes së privatësisë, në përdorimin e burimeve për pasqyrimin e fëmijëve, në sensacionalizmin përballë gazetarisë së komunitetit, etj. Sektorët që pasojnë identifikojnë problemet që mbizotërojnë, temat, si dhe rastet që kanë të bëjnë me pasqyrimin e fëmijëve në gazeta. Duke e ilustruar analizën me artikujt për ngjarjet dhe rastet më domethënëse që kanë të bëjnë me të miturit, kjo analizë do të përpiqet të hedhë dritë për problemet dhe përmirësimet kryesore që ka bërë media shqiptare në lidhje me pasqyrimin e fëmijëve.

Identifikimi i të miturve

Një nga aspektet më të ndjeshme të monitorimit të pasqyrit të fëmijëve studimi i mënyrës se si ata identifikohen, paraqiten dhe trajtohen, sidomos në kohë telashesh dhe rastesh që kanë të bëjnë me kronikën e zezë. Natyrisht që këto janë raste delikate edhe për të rriturit; megjithatë, nga pikëpamja etike ato marrin një rëndësi të veçantë kur bëhet fjalë për fëmijët, duke pasur parasysh kujdesin dhe metodat e veçanta që duhen përdorur për fëmijët. Krahasuar me disa vite më parë, kur identifikimi dhe pasqyrimi i të miturve ishte një problem madhor në median shqiptare, ka pasur përmirësime të ndjeshme në këtë fushë. Gjithashtu, vlen të përmendet se ky aspekt ka patur përmirësim edhe krahasuar me monitorimin me të njëjtat parametra që është bërë një vit më parë.

Më në veçanti, tipari kryesor me të cilin mund të fillojë kjo analizë është identifikimi i të miturve në media. Edhe pse në dukje i thjeshtë, në praktikë ekzistojnë mënyra të ndryshme të zgjidhjes së këtij problemi dhe fatkeqësisht, ka ende disa prej tyre që nuk kanë parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Megjithatë, duhet përmendur se mënyra më e zakonshme për të identifikuar të miturit në këto gazeta është me anë të moshës dhe inicialeve. Përrjashtim në këtë rast bëjnë vetëm ato artikuj kur të miturit janë në aspekte pozitive (kryesisht për portrete) dhe ato raste kur të miturit kanë probleme të ndryshme, por është e qartë nga konteksti i artikullit që prindi jo vetëm ka dhënë lejen për identifikimin dhe intervistimin e fëmijës, por është dhe vetë pjesëmarrës në artikull.

Për të vënë në dukje disa nga shkeljet e rralla të këtij aspekti, analiza do të sjellë shembujt përjashtues të rregullës së identifikimit të të miturve. Rastet më flagrante zakonisht kanë të bëjnë me ngjarje të lidhura me kronikën e zezë, edhe pse kjo është një nga temat që lë më shumë pasoja, jo vetëm te të miturit, por te të gjithë. Edhe pse prania e kronikës së zezë ka qenë e ndjeshme në pasqyrimin total të fëmijëve, sic u përmend më sipër, nuk janë vërejtur shkelje të rënda në aspektin e identifikimit të të miturve.

Rastet përjashtuese janë të pakta, por të rëndësishme për t'u identifikuar dhe për t'u diskutuar. Për shembull, një rast i izoluar është ai që lidhet me arrestimin e një të mituri nga policia, e cila kishte ngatërruar moshën dhe e kishte bërë publike identitetin e tij. Edhe pse është e qartë që gazeta vë në dukje shkeljen e policisë në këtë rast, ajo përsërit të njëjtin gabim duke botuar edhe foton, edhe emrin e plotë të të miturit.¹

Një tjetër rast që lidhet me mënyrën e identifikimit është ai i një 11-vjeçari që bëri disa vjedhje në këtë periudhë, Markeljan Cungu. Edhe pse në fillim gazetat e identifikuan vetëm me iniciale, ky ishte vetëm fillimi. Nuk vonoi shumë dhe pothuajse të gjitha gazetat, me pak përjashtime, jo vetëm që e identifikuan me emër të plotë, por edhe me foto, madje me një foto ku mbante edhe një kapelë policie. Gazetat iu referuan si fenomen, për vetë moshën e re që kishte dhe për shkathtësinë në vjedhje. Edhe pse ky përbënte një lajm të pazakontë nga hajdutët e tjerë, në këto raste duket qartë që gazetat i kanë dhënë përparësi anës kurioze të ngjarjes dhe jo fenomenit në vetvete, e as anës etike për të mos identifikuar të mituri që përfshihen në krime.

Megjithatë, duhet thënë që këto janë në të vërtetë raste të izoluar. Për shembull, mund të thuhet një provë mjaft të mirë media ka kaluar me pasqyrimin e rastit të abuzimit me fëmijët në qendrën "Fëmijët e tij." Duhet thënë që në fillim se në këtë çështje të vështirë gazetat kanë mbajtur një qëndrim të unifikuar dhe nuk kanë identifikuar asnjë nga dëshmitarët, përveçse me moshë dhe në ndonjë rast të izoluar vetëm me iniciale. I vetmi përjashtim lidhet me një artikull të botuar te "Panorama," i cili përqendrohet te dëshmia e një fëmije që jetonte dikur në qendër dhe tashmë ishte 18 vjeç. Personi është identifikuar edhe me foto gjatë procesit, por edhe me si "F.Kovaçi." Megjithatë, ky person nuk hynte te të abuzuarit dhe ishte vetëm në cilësinë e dëshmitarit.

Edhe pse praktika e identifikimi të të miturve është përmirësuar mjaft, sidomos në lidhje me kronikën e zezë, ana e errët mbetet ende raportimi për vetëvrasjet, ku rrallë ndodh që të miturit që vrasin veten ose përpiqen të vrasin veten, të mos identifikohen në artikuj. Ndonjëherë ka edhe raste kur botohen foto të të miturit, gjë që dëshmon edhe për praninë dhe përpjekjet e gazetarëve pranë familjeve të këtyre personave, duke hyrë në jetën private në këto raste të vështira.

Zakonisht këto raste të dhimbshme paraqiten me nota sentimentaliste dhe gati me keqardhje, duke u përqendruar në arsytet dhe mënyrën e vetvrasjes. Disa nga shembujt janë:

*"Burimet policore bëjnë të ditur se adoleshenti i dha fund jetës, pasi nuk i pëlqente pamja e tij e jashtme."*²

*"Si mjet ka zgjedhur një litar dhe si bashkëpunëtorë një pemë që ndodhej pak metra larg tij."*³

¹ "I mituri, policia i ngatërroi moshën," *Shqip*, 08/07/2008, f.21.

² "Vetëvaret adoleshenti, ndihej i shëmtuar," *Gazeta Shqiptare*, 06/09/2008, f.17.

³ "Nuk kishte rroba, vetëvaret nxënësi," *Gazeta Shqiptare*, 22/11/2008, f.12.

“Vogëlushi vari veten vetëm pak metra larg shtëpisë, pasi nuk donte të shkonte më në shkollë me rroba të grisura.”⁴

Pasqyrimi i vetëvrasjeve të të miturve paraqet dy probleme. I pari u përmend më sipër dhe ka të bëjë me ndërhyrjen në jetën private dhe në dhimbjen e të afërmëve. I dyti ka të bëjë me misionin e medias në funksion të interesit publik. Këto raste, të raportuara të veçuara, nuk paraqesin interes publik. Edhe pse të rënda, nëse raportohen si lajme të izoluara në kohë dhe vazhdimësi, dhe jo si fenomen dhe shkaqet që sjellin këtë fenomen, këto vetëm sa lëndojnë akoma më shumë plagët që janë hapur pa u bërë publike ngjarja. Gjithashtu, ky raportim pa asnjë lloj frenimi dhe me çdo kusht për vetëvrasjet dhe sidomos për mënyrën e vetvrasjes, e shndërrojnë këtë fenomen mjaft të rëndë gati në normalitet, duke e bërë më të pranueshme për persona të tjerë këtë akt dhe duke ulur gjithnjë e më shumë vlerën e jetës. Nuk janë të pakta studimet që këshillojnë për një maturi nga ana e medias, sidomos në raportimin e mënyrës së vetvrasjes, pasi kjo mund të jetë dhe një shkas imitimi për raste të tjera. Edhe përmes shqiptare, një modifikim i raportimit të vetëvrasjeve nga rastet e izoluara në fenomenin dhe nga mënyrat e vetëvrasjes në identifikimin e përgjithshëm të shkaqeve dhe zgjidhjeve, do të ndihmonte në një përmbushje më të mirë të interesit publik.

Pasqyrimi i arsimit, një hap më tej

Një nga temat më të pasqyruara ka qenë ajo e arsimit, problemet me infrastrukturën e tij, si dhe aspekte të tjera. Arsyeja kryesore për shpeshësinë e artikujve për këtë temë ka qenë dhe fillimi i vitit shkollor në shtator dhe probleme të tjera që e pasuan në tetor.

Shumica e artikujve për këtë temë është e lidhur me mungesën e kushteve të përshtatshme në shkolla dhe kopshte, si dhe me probleme të tjera, të lidhura ose jo me shkollën. Shumica e gazetave përmbanin jo thjesht artikuj të shkurtër përshkruar për ditën e parë të shkollës, por edhe reportazhe prej dy faqesh për fillimin e vitit shkollor, duke u përqendruar sidomos te klasa e parë apo te problemet e reja dhe të vjetra.

Ndërkohë që shumica e problemeve të trajtuara (infrastruktura e keqe e shkollës, shpenzimet e larta për prindërit, mungesa e teksteve, etj) ishin të njohura për lexuesin, kishte dhe një temë tjetër ku gazetat rrallë përqendrohen, ajo e fëmijëve të ngjuar për shkak të gjakmarrjes, të cilët nuk mund të shkonin në shkollë si bashkëmoshatarët e tyre. Kështu, disa gazeta thjesht raportuan për këtë problem tashmë të vjetër dhe ende të pazgjidhur, por edhe për përpjekjet nga shoqëria civile për të ndihmuar fëmijët e ngjuar:

„Gjashtëdhjetë fëmijë që janë të ngjuar për shkak të gjakmarrjes së familjeve të tyre, nga 100 që janë të evidentuar në Shkodër, mund të ndjekin mësimet, falë punës këmbëngulëse të Misionit të Pajtimit të Gjaqeve në këtë trevë.”⁵

Ose:

⁴ “Skamja, 11-vjeçari var veten për shkak të rrobave të grisura,” *Shekulli*, 23/11/2008, f.6.

⁵ “‘Shansi i dytë’ u mundëson shkollim 60 fëmijëve të ngjuar,” *Gazeta Shqiptare*, 14/09/2008, f.15.

“Rreth 100 fëmijë në Qarkun e Shkodrës nuk do të ulen në bankat e shkollës më 15 shtator. Frika e gjakmarrjes i ka lënë ata të ngujuar në shtëpi.”⁶

Megjithatë, reportazhi më i plotë dhe më i prekshëm për këtë temë vjen nga Neë York Times, i ribotuar në “Gazeta shqiptare.”⁷ Në këtë rast gazetari, nëpërmjet dëshmisë së një familjeje të ngujuar, së bashku me shifra dhe raporte të ndryshme për këtë aspekt, përcjell këtë problem të pazgjidhur të shoqërisë shqiptare, duke e sjellë atë më pranë lexuesit. Janë vetë dëshmitë e 17-vjeçarit të ngujuar që është intervistuar që e bëjnë më të afërt këtë plagë:

“Ëndërroj të jem i lirë dhe të mund të shkoj në shkollë, do të doja vetëm të dilja nga kjo derë. Të jetosh kështu është më keq se dënimi me burg.”

Përveç gjakmarrjes, vëmendje e veçantë këtë vit i është kushtuar edhe problemeve të shkollës për minoritetet, më saktë për minoritetin grek. Problemet që janë trajtuar kanë të bëjnë si me hapjen e shkollave të reja greqisht, ashtu dhe me krijimin e teksteve greqisht, të cilat mungojnë prej vitesh në këto shkolla. Kështu, disa artikuj ndjekin në kohë ecurinë e teksteve greqisht për fëmijët e minoritetit dhe më vonë edhe për marrëveshjen mes shtetit shqiptar dhe atij grek për shkollat e reja dhe për tekstet greqisht⁸. Madje, këtë vit pati edhe një editorial për këtë temë, kundër përpjekjeve të pamjaftueshme të Ministrisë së Arsimit, por sidomos kundër pasivitetit të përfaqësuesve të PBDNJ për këtë problem.⁹

Gjithashtu, kur flitet për mbulimin e arsimit, duhet përmendur se pasqyrimi i problemeve, sidomos me infrastrukturën, ka ardhur duke u përmirësuar dhe duke mbuluar një zonë gjeografike gjithnjë e më të gjerë. Ndërkohë që problematika është e ngjashme me vitin e kaluar (problemet me ndërtesat ose infrastrukturën e shkollave, me tekstet, me marrëdhëniet mësues-nxënës, etj.) këtë vit vërehet një larmi më e madhe përsa i përket mbulimit gjeografik. Për shembull, po të marrim pasqyrimin e vetëm njëres nga gazetat¹⁰ në ditën e parë të shkollës, do të vërejmë këto tituj: „Shkolla e Gërdecit e rrënuar, si më 15 mars, „Lushnje, 500 nxënës në protestë për kushtet në shkollë,“Kurbini, mësim me turne në disa shkolla, s’ka mjedise e bazë materiale,“ „Presidenti në Elbasan për 100-vjetorin e „Naim Frashërit,“ etj.

Gjithashtu, duhet thënë se pasqyrimi i problematikës nuk është bërë vetëm në ditën e parë të shkollës, siç ndodh rëndom, por ka vazhduar më gjatë. Disa nga artikujt që hasen në këtë aspekt janë këto: „Skandal në Fier, shkollë në lokalit dhe duhanit,“¹¹ „Bathore, tri klasa kopsht për 170 fëmijë,“¹² „Cudia në Fier, nxënësit mësim me patat,“¹³

⁶ “Shkodër, gjakmarrja lë 100 fëmijë pa shkuar në shkollë,” Panorama, 14/09/2008, f.11.

⁷ Dan Bilefsky, “Gjakmarrja në Shqipëri,” Gazeta Shqiptare, 11/07/2008, f.14-15.

⁸ “Drejtori i shkollës në Dervician: Tani do mësojmë me tekste greqisht,” Gazeta shqiptare, 11/09/2008, f.3, “Gjirokastër, vijnë librat në greqisht,” Gazeta Shqiptare, 30/10/2008, f.23, “Fëmijët e minoritetit, përsëri pa libra,” Shqip, 30/08/2008, f.9.

⁹ Panajot Barka, “Minoriteti pa shkolla shtetërore,” Gazeta Shqiptare, 28/09/2008, f.28.

¹⁰ Gazeta Shqiptare, 16/09/2008, f.12-13.

¹¹ Shekulli, 20/09/2008, f.8.

¹² Gazeta Shqiptare, 14/11/2008, f.18.

¹³ Shekulli, 01/10/2008, f.18.

„Mësim në lokal, DAR çon nxënësit në Kallm të Madh,“¹⁴ „Fier, shkollat pa sisteme ngrohjeje rrezikojnë mbylljen.“¹⁵

Ndryshe nga herë të tjera, edhe pse në numër të kufizuar, janë shfaqur edhe disa artikuj që prekin tema të parrahura për grupe që mund të përkufizohen si minoritete. Kështu, pati disa artikuj për mundësitë për arsim të personave me aftësi të kufizuara¹⁶, për nxënësit romë¹⁷, dhe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë që arsimohen jashtë¹⁸. Pra, edhe pse këto artikuj për grupe apo tema të kufizuara mbeten të pakta dhe sporadike, numri i tyre ka ardhur në rritje dhe ky është një hap përpara në pasqyrimin e përgjithshëm të fëmijëve.

Fëmijët dhe shëndeti

Një temë që dalngadalë ka zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në gazetate e përditshme është ai i shëndetit të fëmijëve. Kjo temë përgjithësisht është trajtuar në dy mënyra: nga ana e mungesës së infrastrukturës së spitaleve dhe mungesave të tjera të shërbimit shëndetësor në vend, por edhe në ngritjen e problemeve që kanë të bëjnë me ushqimin dhe me mënyrën e rritjes së fëmijëve në përgjithësi. Kështu, shfaqen artikujt me probleme të reja që janë shfaqur edhe në shoqërinë shqiptare, si obeziteti i fëmijëve, mënyra e të ushqyerit të tyre, diabeti që prek fëmijët gjithnjë e më shumë, etj. Këto janë problemet më të prekura, por ka edhe raste kur preken sëmundje më të rralla si autizmi. Disa nga titujt që hyjnë në këtë kategori janë: „Mjekët na lëndojnë, nuk kanë etikë në komunikim,“¹⁹ „Fëmijët, sëmundjet respiratore e obeziteti më të shpeshtat,“²⁰ „Fëmijët mbipeshë, me arterie 45-vjeçare,“²¹ „Diabeti, 1 mijë fëmijë mbartës,“²² „Autizmi, një diagnozë e fshehtë nga se të ruajmë fëmijët.“²³

Këto artikuj në përgjithësi ose evidentojnë me shifra problemet që hasen dhe gjenden në vend, ose janë në formën e intervistave apo artikujve ndihmës për prindërit në këto aspekte. Pra ajo që i bashkon këto artikuj është fakti se janë një dritare ndihme dhe informacioni për prindërit, duke u nisur që nga problemet më ordinere si gripit dhe vaksinat, te sëmundjet më të ndërlikuara si diabeti, e deri te këshillat për psikologjinë e fëmijëve, si përshebull si duhet folur me një fëmijë për seksin. Gjithsesi, pavarësisht temës apo formës, këto artikuj janë një risi që vetëm e pasurojnë mbulimin e problemeve të fëmijëve në shtypin shqiptar.

Gazetaria komunitare

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Shqip, 07/10/2008, f.25.

¹⁶ Standard, 24/10/2008, f.21.

¹⁷ „Lidhet uji, rihapet shkolla e fëmijëve romë,“ Shqip, 07/10/2008, f.25.

¹⁸ „Mbi 85 mijë fëmijë shqiptarë mësojnë në shkollat italiane,“ Shqip, 21/09/2008, f.35.

¹⁹ Shekulli, 27/10/2008, f.11.

²⁰ Panorama, 15/11/2008, f.15.

²¹ Panorama, 19/11/2008, f.22.

²² Gazeta Shqiptare, 15/11/2008, f.14.

²³ Standard, 18/09/2008, f.19.

Shumë nga artikujt e shëndetësisë, por jo vetëm, ndërkohë që përshkruajnë problemet e fëmijëve, disa nga artikujt janë shkruar në një mënyrë që tregon dhe përfshirjen e gazetarit në kauzën e përmirësimit të gjendjes së fëmijëve. Në disa artikuj kjo prirje është më e qartë se në të tjera. Përveç problemeve të zakonshme të infrastrukturës në shkollë, monitorimi i këtij viti ka identifikuar një numër në rritje të artikujve ku gazetarët kanë prirjen t'i ndihmojnë fëmijët edhe për probleme të tjera me anë të artikujve të tyre. Këto probleme zakonisht kanë të bëjnë me fëmijë të prekur nga sëmundje të vështira, të cilët jetojnë në varfëri dhe nuk kanë mundësi shërimi, ose për fëmijë të varfër, zakonisht jetimë, të cilët bëjnë thirrje për ndihmë nëpërmjet këtyre artikujve.

Një shembull është ai i një jetimi që shkon fshehurazi në shkollë, pasi është i paregjistruar²⁴, ose ai i një jetimi tjetër, i cili, së bashku me shokët e vet, nuk kanë burime për të blere libra dhe mjete të tjera shkollore e për të pasur një jetë normale²⁵. Jo rrallë këto artikuj, për shkak edhe të qëllimit që kanë, përdorin nota sentimentaliste dhe përfshijnë detaje prekëse:

„Kur vëren jetesën e kësaj familjeje, fatin e dhimbshëm të fëmijëve të saj barkbosh e të pashkollë, legjenda e „Luli të vocërr“ e Migjenit do të ishte një luks për ta. Djali i dytë i Markajve, Kujtimi 12-vjeçar, vetëm pas tre orësh pranoi të hapë gojën e të flasë. Na thotë se bashkë me tre fëmijët e tjerë të familjes në moshë, nuk shkojnë në shkollë se nuk kanë libra, fletore, mjete të tjera mësimore; nuk kanë as rroba e as këpucë për të veshur. „Kemi dëshirë të shkojmë, po kështu nuk mundemi,“ - shprehet mes lotëve ai. Por tjetër hall ka ai: nuk ka bukë për të ngrënë, se mielli mbarohet...²⁶

Një shembull tjetër vjen nga artikujt që kanë për qëllim të ndihmojnë fëmijët e sëmurë:

„Këtij fëmije i është ndërprerë e folura, e ecura dhe buzëqeshja, lutemi të mos i ndërpritet jeta,“ - pohon Hajria, të cilës nuk i thahen faqet nga lotët që i rrjedhin pa pushim.²⁷

Keta artikuj janë shembuj të qartë të gazetarëve që përdorin fuqinë e medias për të ndihmuar në një lloj mënyre njerëziteti në nevojë, duke ngritur ndërgjegjësimin për problemet e tyre. Megjithatë, ekuilibri midis ruajtjes së dinjitetit të personave dhe ndihmesës së dhënë ndaj tyre është gjithnjë delikat dhe i vështirë për t'u arritur.

Ngjan se jetimet dhe fëmijët e braktisur janë tema shumë të ndjeshme për gazetarët dhe gazetaret, sepse ato janë ndër temat më të pasqyruara. Megjithatë, rrallë ndodh që të ketë një përpjekje të përbashkët dhe të organizuar për të pasqyruar këto tema si një fenomen, me të gjitha të dhënat dhe mendimet që mund të mblidhen, me rastet e veçanta për të përshkruar fenomenin, si dhe me kërkimin e zgjidhjeve të mundshme. Në fakt, siç ndodh

²⁴ “Shkon fshehurazi në shkollë, sepse është i paregjistruar,” *Shqip*, 04/06/2008, f.7.

²⁵ “Elvisi, drama e jetimit që kërkon të shkollohet,” *Gazeta Shqiptare*, 26/10/2008, f.19.

²⁶ Armir Mehja, “Markajt, familja që po vdes për bukë,” *Gazeta Shqiptare*, 13/10/2008, f.16.

²⁷ Eglantina Bardhi, “Alkeoni, fëmija me sëmundjen e rrallë, shpresë në spitalet turke,” *Shekulli*, 07/08/2008, f.11.

me shumë tema të tjera, vetëm rastet më të ndryshme paraqiten, të cilat rrallë pasohen më tej me ndjekje të fenomenit, shkaqet e tij, ndikimin dhe zgjidhjen e tij.

Të miturit dhe trajtimi i fenomeneve

Edhe pse në përgjithësi pasqyrimi i të miturve në shtypin shqiptar mbetet ende në kufirin e lajmeve dhe ngjarjeve të përditshme dhe rrallë shtrihet te fenomeni, kjo prirje dalngadalë ka nisur të ndryshojë. Nga ky monitorim, është vërejtur se gjithnjë e më shumë po shfaqen artikuj që përpiqen të shkojnë përtej ngjarjeve apo personave të momentit dhe t'i përdorin ata si spunto për të pasqyruar apo analizuar edhe fenomenin dhe ndikimin që ai ka te shoqëria.

Temat janë nga më të ndryshmet, duke nisur nga vdekshmëria foshnjore, te drejtësia për të miturit, te procesi i riedukimit të tyre, te fëmijët e rrugës, te abuzimi me fëmijët në shkollë ose në familje, te fëmijët me anomali fizike, fëmijët dhe obeziteti e deri te analfabetizmi i fëmijëve. Vëmendje e posaçme u është kushtuar adoleshentëve dhe aspekteve më të vështira dhe problematike të jetës së tyre, të tilla si armët nëpër shkollat e mesme, adoleshentët dhe seksi, adoleshentët dhe kriminaliteti, si dhe aspekteve që mund të mos jenë problematike, por janë të rëndësishme dhe përshkruese dhe që zakonisht kanë të bëjnë me mënyrën e jetesës së adoleshentëve.

Mënyra se si këto fenomene janë trajtuar nëpër gazeta është e ndryshme, në varësi të mjeteve, të dhënave, apo zërave që janë përdorur për të ilustruar problemin. Mënyrat variojnë në marrjen e mendimit të ekspertëve, në marrjen e opinionëve nga vetë të miturit, në përdorimin e shifrave zyrtare, apo të dhëna nga studime dhe nga sondazhe, këshilla nga psikologu, etj. Për shembull, njëri nga artikujt i kushton vëmendje marrëdhënies së adoleshentëve me seksin²⁸, duke përfshirë të dhëna nga sondazhet dhe studimet e fundit:

“Kanë qenë specialistët e ISHP që kanë analizuar sjelljet në risk të adoleshentëve. Ata kanë anketuar më shumë se 4500 nxënës të shkollave të mesme, nga ku kanë dalë të dhëna alarmante për një sërë fenomenesh që kanë mbërthyer brezin e ri. Rreth 10% e gjimnazistëve të anketuar pohojnë se kanë pasur më shumë se dy të dashur në vitet e gjimnazit. Rreth 29% e tyre pranojnë se kanë kryer marrëdhënie seksuale për herë të parë në vitin e katërt të gjimnazit, ndërsa 15% e tyre kanë pranuar se kjo gjë ka ndodhur në vitin e parë.”

Të shpeshtë janë gazetarët që u drejtohen ekspertëve dhe sidomos psikologëve në temat që kanë të bëjnë me fëmijët, sidomos me adoleshentët dhe me sjelljen e tyre. Për shembull, një prej tyre, i cili fokusohet te adoleshentët²⁹ dhe tendencat që kanë për vetëvrasje, bazohet te mendimet e marra nga tre psikologe të punësuar pranë tre gjimnazeve kryesore në Tiranë.

²⁸ Zirina Llambro, “Adoleshentët, 15% seks që në vitin e parë të gjimnazit,” Panorama, 11/08/2008, f.11.

²⁹ Eglantina Bardhi, “Adoleshentëve nuk u kushtohet vëmendje, tentojnë vetëvrasjen,” Shekulli, 12/06/2008, f.13.

Një temë tjetër e prekur në mënyrë të ndjeshme gjatë kësaj periudhe ka qenë dhe fenomeni i krimit mes të miturve dhe nevoja për shkollë riedukimi. Përshkrimi i këtij fenomeni, i shfaqur herë më pak e herë më shumë, është përforcuar me mendime nga ekspertët, me shifra, por edhe me intervista nga vetë të miturit. Madje, njëra nga të përditshmet i kushtoi një suplement të tërë të miturve në burgje dhe shkollave të riedukimit³⁰. Ajo që ia vlen të theksohet në trajtimin e problemit të kriminalitetit të të miturit është se format e përshkrimit vetëm me anë të ekspertëve apo me shifra të raporteve zyrtare nuk janë më të vetmet që përdorin gazetarët.

Artikujt e kësaj teme gjithnjë e më shumë përfshijnë edhe intervista me ata që janë njëkohësisht të dëmtuarit dhe dëmtuesit, në një përpjekje për të pasqyruar dhe analizuar fenomenin me anë të rasteve konkrete më të spikatura. Kështu, në një artikull gazetari ka intervistuar një të mitur në një burg të miturish në Vaqarr, i cili shpjegon se si jeta i është kthyer në një rreth vicioz, pasi i shtyrë të vidhte nga vështirësitë e adoleshencës së tij, tashmë nuk mund ta ndreqë më dëmin dhe gjithkund ndihet i damkosur, gjë që e shtyn sërish në jetën e vjetër, duke qenë më shumë në shkollë riedukimi sesa në shtëpi të tij. “Në çdo vend që shkoj, ata që më njohin më etiketojnë me pseudonimin kriminel. Kjo është një gjë e padurueshme për mua. Kam tentuar tre herë të vras veten.”³¹ Rasti i këtij të mituri nuk serviret vetëm si një ngjarje kurioze apo e dhimbshme, por shërben në një farë mënyre për të bërë më të prekshme gjendjen e të miturve nëpër burgje dhe nëpër shkollë riedukimi, siç dëshmon artikulli ngjitur me të, ku merren dhe dëshmitë dhe mendimet e punonjësve socialë dhe të drejtorit të burgut të Vaqarrit.³² Gjithashtu, artikulli përshkruan dhe dëshirat dhe mendimet e vetë të miturve për të ardhmen e tyre pas riedukimit, gjë që ndihmon deri diku të japë një pamje më të plotë për lexuesin të këtyre të miturve e të zbehë sadopak njollën e burgut apo të riedukimit.

Një problem që është trajtuar gjithnjë e më shumë në shtypin shqiptar është i lidhur me shëndetin e fëmijëve dhe në mënyrë të veçantë me obezitetin, që duket se po prek gjithnjë e më shumë fëmijët shqiptarë. Në të gjitha gazetat nuk kanë munguar artikuj me raporte apo këshilla të ekspertëve për këtë problem. Gjithashtu, ka pasur edhe gazetarë që nuk janë mjaftuar me kaq, por kanë marrë intervista dhe kanë sjellë për lexuesin fëmijë dhe prindër të gatshëm të hapen për problemin me të cilin përballen: obezitetin të fëmijët. Kështu, një artikull i tërë është ndërtuar mbi intervistën e një vajze 11-vjeçare dhe mamasë së saj për këtë temë³³, duke shërbyer si referencë për të tjerë që kanë të njëjtin problem e duke folur më lirshëm për të gjetur zgjidhje e për të thyer tabutë.

Pra, aspekti që mund të thuhet se po përmirësohet në pasqyrimin e të miturve ka të bëjë me prekjen e problemeve të tyre jo më vetëm nga ekspertët apo nga statistikat, por dalngadalë edhe nga ata vetë, duke rritur ndërgjegjësimin me anë të dëshmive dhe zërave të vetë fëmijëve. Gjithashtu, përforsimi i përshkrimeve të problemit duke përdorur opinionet e ekspertëve, raportet zyrtare, statistikat dhe intervista të ndryshme, ka sjellë një përmirësim të trajtimit të fenomeneve për publikun. Megjithatë, mbetet ende shumë

³⁰ “Të miturit,” *Gazeta Shqiptare*, 30/10/2008, f. 17-21.

³¹ Gertjon Cobo, “Jeta e Toptanit, mes rrugës dhe burgut: Vjedh për inat,” *Shekulli*, 24/11/2008, f.8.

³² Gertjon Cobo, “Të miturit në burgje, sa pak riedukim!”, *Shekulli*, 24/11/2008, f.9.

³³ Eglantina Bardhi, “Arista, e vogël dhe e madhe...” *Shekulli*, 16/08/2008, f.23.

punë për të bërë në këtë aspekt, sidomos përse i përket sistematikës së ndjekjes së fenomeneve dhe shmangjes së notave sentimentaliste që hasen shpesh në këto raste.

Zërat e fëmijëve

Një numër shumë i vogël, por përfaqësues i një prirjeje të re, ishin artikujt që përqendroheshin te portretet e të miturve apo te aspekte të jetës së tyre që normalisht nuk do të përbënin lajm. Në fakt, edhe numri shumë i pakët i këtyre artikujve, edhe ngjyrat e tyre optimiste, janë në kundërshtim me shumicën dërrmuese të artikujve të tjerë të monitoruar.

Artikujt të tillë kanë të bëjnë me portrete të fëmijëve ose të miturve që kanë një talent të caktuar apo që kanë shkëlqyer në shkollë. Për shembull, njëri nga artikujt përqendrohet te fituesit e maturës shtetërore, duke përshkruar ata, pararendësit e tyre, si dhe duke u ndalur te dëshirat dhe ëndrrat që kanë ata.³⁴

Disa artikujt të tjerë shkojnë dhe më tej dhe merren me atë që mund të quhet ndryshimi i mënyrës së jetesës në fëmijët e brezit të sotëm dhe për pasojë dhe e vlerave në shoqëri mes fëmijëve. Kështu, njëri nga artikujt ka në qendër fëmijët e klasës së parë, duke përshkruar emocionet e tyre në kontaktin e parë me shkollën e duke bërë dhe krahasimin me nxënësit e të djeshmes, si në mësim, ashtu dhe në mënyrën se si e përjetonin shkollën si eksperiencë. Artikulli ndërtohet si te fjalët e fëmijëve, ashtu dhe të mësueses, duke u përpjekur të japë një pamje më të plotë të mënyrës si ka ndryshuar arsimit dhe shoqëria në vite³⁵.

Të njëjtat ndryshime përpiqet të përshkruajë edhe një artikull tjetër, i cili ka në qendër preferencat e fëmijëve dhe dëfrimin e tyre. Të ndikuar gjithnjë e më shumë nga televizioni dhe filmat vizatimorë, shprehja e fëmijëve në vizatimet e tyre është shumë larg realitetit dhe vizatimeve që bëheshin një brez më parë në të njëjtën moshë:

“Ka nga ata mësues të cilët nuk ngurrojnë të flasin për fenomenin shterpëzues që televizioni po brumos te fëmijët...Nuk është e vështirë të kuptosh se izolimi para ekranit të vogël po krijon një perceptim krejt tjetër nga realiteti për fëmijët.”³⁶

Pra, edhe pse copëza të vogla dhe në dukje pa ndonjë peshë, këta artikuj përpiqen të hedhin më shumë dritë në mënyrën se si po ndryshon bota e fëmijëve nga dita në ditë, shpesh duke i bërë ata vetë zëdhënës të kësaj bote. Ajo që është më e rëndësishmja, këto janë pjesë shumë të vogla, por mjaft pozitive në pamjen e përgjithshme të medias për të miturit, që zakonisht është mjaft e zymtë me dhe për ta.

Suplementi “Gjimnazistët”

³⁴ Ardit Bido, “Absolutja 2008,” Standard, 13/09/2008, f.13.

³⁵ Dritan Laci, “Me buzëkuq në ballë,” Shekulli, 07/10/2008, f.12.

³⁶ Dritan Laci, “Unë jam një Goku,” Shekulli, 16/10/2008, f.13.

Një praktikë që ka nisur dy vitet e fundit ka qenë nisma e “Gazeta Shqiptare,”: botimi i një suplementi të përjavshëm vetëm për gjimnazistët. Gjatë gjithë vitit shkollor, një herë në javë, gazeta përqendrohet vetëm me atë që ndodh nëpër gjimnazet e kryeqytetit, duke krijuar një hapësirë për këtë grupmoshë, e cila rrallë ka mundësinë të shprehet në median e shkruar. Për më tepër, ndryshe nga çdo hapësirë tjetër që u kushtohet të miturve, në këtë supplement gjimnazistët mund të shkruajnë edhe vetë, siç ndodh shpesh, e jo të shprehen vetëm nëpërmjet gazetarëve.

Suplementet përshkruajnë kryesisht problemet e përditshme të gjimnazistëve, duke nisur nga problemet infrastrukturore në shkollë, sfidat me të cilat përballen arsimi e ata vetë, ngjarjet jashtëshkollore, përplasja mes brezave apo marrëdhëniet mësues-nxënës, e deri te mënyra e jetesës së këtij brezi. Kështu, në suplemente gjen tituj të llojit: “Përplasen nxënësit me drejtorinë,”³⁷ “Sa ka funksionuar uniforma në Qemal Stafa?”³⁸, “Klubi i ekologjistëve ‘Kristal’ tashmë me një faqe interneti,”³⁹ “Një pasdite e bukur poetike”⁴⁰, “Rini e dhunshme në Shqipëri,”⁴¹ “Chat: Sa të lidhur jemi me të?”⁴² “‘Cajupi’ feston muajin e letërsisë,”⁴³ “A do të jenë të sigurt fëmijët nëpër shkolla?,”⁴⁴ “Mësuesit presion nxënësve: në kurse private,”⁴⁵ “Ekonomiku në panairin ndëkombëtar në Stokholm,”⁴⁶ “Gjimnazistët shpenzojnë për kafe, telefon dhe cigare.”⁴⁷

Pra, siç mund të shihet nga titujt, përmbajtja e artikujve në këto suplemente është mjaft e larmishme dhe përpiket të japë një pamje sa më të plotë të problematikës së këtij grupi. Për më tepër, suplementet u lënë mundësi dhe vetë gjimnazistëve të shprehen për probleme që i shqetësojnë. Jo rrallë në këto suplemente gjen letra shpjeguese ose mendime të firmosura nga një klasë e tërë. Gjithashtu, informacione për aktivitete jashtëshkollore si faqe interneti të ngritura nga ata vetë, pjesë teatrore të vëna në skenë, konkurse letrare, etj, shkruhen me raste edhe nga vetë gjimnazistët. Pra, kjo hapësirë për gjimnazistët jo vetëm është ekskluzivisht për ta dhe mbi ta, por sjell dhe vetë optikën e tyre për problemet dhe temat e ndryshme që trajtohen.

Ashtu si dhe pjesë të tjera të gazetës, çdo suplement boton dhe një rubrikë të ngjashme me “pyetje e përgjigje,” ku psikologu u përgjigjet pyetjeve të bëra nga gjimnazistët për probleme që i shqetësojnë. Problemet janë nga më të ndryshmet, si grindjet në familje, kontrolli i prindërve, emocionet kur ngrihen në mësim, droga në shkolla, marrëdhëniet mes gjimnazistëve, etj. Kjo rubrikë, përveçse krijon një mundësi shprehjeje për vetë

³⁷ Ilda Lumani, Gazeta Shqiptare, 26/11/2008, f.17.

³⁸ Xhulia Karavella, Gazeta Shqiptare, 26/11/2008, f.21.

³⁹ Gazeta Shqiptare, 19/11/2008, f.18.

⁴⁰ Gazeta Shqiptare, 19/11/2008, f.21.

⁴¹ Ilda Lumani, Gazeta Shqiptare, 12/11/2008, f.19.

⁴² Xhulia Karavella, Gazeta Shqiptare, 12/11/2008, f.21.

⁴³ Eni Beci, Gazeta Shqiptare, 12/11/2008, f.23..

⁴⁴ Arsen Rusta, Gazeta Shqiptare, 17/09/2008, f.19.

⁴⁵ Gazeta Shqiptare, 15/10/2008, f.17.

⁴⁶ Aimona Vogli, Gazeta Shqiptare, 22/10/2008, f.22.

⁴⁷ Aimona Vogli, Gazeta Shqiptare, 08/10/2008, f.22.

gjimnazistët, përbën dhe një lloj hapësire të sigurtë ku ata mund të marrin informacionin dhe këshillat që kërkojnë.

Në përgjithësi, botimi i suplementit “Gjimnazistët” krijon një praktikë të re dhe një qasje ndryshe nga gazetave shqiptare drejt grupeve që rrallë e gjejnë veten në gazetë. Duke kombinuar qasjen gazetareske me vetë mendimet dhe zërat e gjimnazistëve, suplementi sjell një pamje më të plotë dhe të larmishme me ato çka përballet ky grup. Për më tepër, rregullsia në kohë e suplementit e dallon atë nga suplemente të tjera po aq të rëndësishme, por që botohen një ose dy herë dhe harrohen.

Përfundimet

Në përgjithësi, mund të thuhet se dalngadalë problemet e fëmijëve po fillojnë të shfaqen në faqet e gazetave shqiptare, në disa më shumë se në disa të tjera. Megjithatë, pasqyrimi i fëmijëve në media, edhe pse mjaft i përmirësuar, është ende larg të qenit i rregullt, sistematik, i përthelluar, apo tërësisht etik. Përpjekjet për të pasqyruar fëmijët dhe për t’u dhënë atyre një zë të vërtetë dhe vendin që meritojnë janë ende mjaft të kufizuara, për arsye të ndryshme.

Për fat të keq, edhe pse çështjet etike padyshim janë përmirësuar në krahasim me disa vite më parë, kronika e zezë vazhdon të mbetet një magnet për shtypin. Në frymën e përgjithshme që ka pushtuar botimet e përditshme, ku kronika e zezë është mbizotëruese dhe pasqyrimi i saj në përgjithësi është sensacional, artikujt ku të miturit janë viktima ose kriminelë nuk mund t’i shpëtojnë kësaj prirjeje. Megjithatë, duhet vërejtur se problemet me identifikimin e të miturve në krime apo ngjarje të rëndë janë gjithnjë e më të pakta dhe se është krijuar një praktikë e mirë në këtë aspekt.

Një tjetër prirje që mund të vihet re në pasqyrimin e të miturve në median shqiptare është ajo i marrjes së tyre nën mbrojtje. Ndërkohë që ka një numër në rritje të artikujve që tregojnë se gazetarët kanë marrë përsipër të ndihmojnë një kauzë apo një rast të veçantë, në këtë mision është e vështirë të shmangen notat sentimentaliste, duke u prirur të vihen nevojat e fëmijëve para dinjitetit të tyre.

Fatmirësisht, gazetave shqiptare po hapen gjithnjë e më shumë për problemet dhe tematikat e ndryshme që shqetësojnë të miturit. Temat e gazetave nuk kufizohen më vetëm te kronika e zezë, por edhe te shëndeti, arsimit, braktisja, apo problemet psikologjike që shqetësojnë të miturit. Në këto artikuj shpesh ndërthuren këshillat e ekspertëve dhe përvojat e vetë të miturve, duke u përpjekur kështu të përmbushet dhe një rol edukativ dhe informativ për këto probleme. Me rëndësi të veçantë për shprehjen dhe pasqyrimin e plotë dhe korrekt të fëmijëve është dhe botimi i suplementit të përjavshëm “Gjimnazistët” të “Gazeta Shqiptare,” i cili shërben si forum për shprehjen e lirshme mes vetë gjimnazistëve, si dhe si një platformë komunikimi mes publikut dhe këtij grupi.